

Komuna e Shtimes 2017: Problemet kryesore dhe trendet buxhetore

Hyrje

Komuna e Shtimes udhëhiqet nga Naim Ismajli nga Partia Demokratike e Kosovës. Ky është mandat i tij i tretë.

Në zgjedhjet e kaluara komunale, kandidatët për kryetar kanë dhënë premtime të cilat nuk bien nën kompetencat vetanake të komunave. Megjithatë, hulumtimet tregojnë se qytetarët e Kosovës kanë njohuri të mjaftueshme mbi ndarjen e kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe lokal.¹ Mbi 82 % e qytetarëve të Shtimes besojnë që pushteti lokal mund t'i zgjidhë të gjitha apo disa nga problemet me të cilat ballafaqohen ata në komunën e tyre.² Ndërsa sa i përket shkallës së kënaqshmërisë së qytetarëve të Shtimes me pushtetin lokal (Kryetarin e Komunës, Kuvendin Komunal dhe Administratën Komunale), del se ka një rritje të lehtë të kënaqshmërisë nga 13.26 pikë në vitin 2012 në 17.19 në vitin 2015.³

Hulumtimet e bëra nga Instituti GAP në fund të vitit 2013 tregonin se problemet kryesore në atë kohë në këtë komunë kanë qenë mungesa e kanalizimeve, mungesa e ndriçimit publik, prezenca e gurëthyesve, mungesa e stacionit të autobusëve, mosmirëmbajtja e lumit dhe mospërkrahje institucionale e klubeve të sportit.

¹ Instituti GAP, Adresimi i Përgjegjësisë: Njohuritë e qytetarëve me kompetencat e komunave. Maj 2017. Burimi: <http://bit.ly/2os7GPU>

² Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 37. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr> (Hapur më 28 qershor 2017)

³ Ibid. faqe 39

Problemet aktuale të Komunës së Shtimes

Ndotja e ambientit nga prezenca e gurëthyesve

Banorët e Komunës së Shtimes ballafaqohen me problemin e gurthyesve të cilët veprojnë në këtë komunë. Janë gjithsej nëntë sosh. Ky problem ka qenë i theksuar edhe në raportin e kaluar të Institutit GAP të vitit 2013. Komuna, gjatë këtij mandati, ka bërë dislokimin e gurthyesve prej nga janë marrë ankesat, mirëpo ankesat e qytetarëve vazhdojnë prej fshatrave ku këta gurthyes janë zhvendosur. Banorët e fshatit Belincë kanë problem më dy gurthyes. Edhe pse shumë herë ata janë ankuar në komunë, komuna iu është përgjigjur se gurthyesit nuk janë kompetencë e komunës, përderisa Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nuk ka lëshuar leje për këta gurthyes po vetëm pëlqim mjedisor.

Mungesa e stacionit të autobusëve dhe parkingjeve publike

Komuna e Shtimes ende nuk ka arritur të ndërtojë stacion të autobusëve. Ky problem është raportuar edhe në raportin e kaluar të GAP të vitit 2013. Përveç kësaj, komuna nuk ka akoma të caktuar linjë të veçantë Shtimje – Prishtinë, edhe pse komuna e ka kërkuar një gjë të tillë në Ministrinë e Infrastrukturës. Gjithashtu, komuna ka mungesë të parkingjeve publike. Këtë e vërteton edhe raporti i MAPL-së, ku mungesa e parkingjeve është vlerësuar si performancë e dobët.⁴

Mungesa e kanalizimeve

Disa fshatra të Komunës së Shtimes kanë mungesë të rrjetit të kanalizimit. Fshatrat që përballen me mungesë të këtij rrjeti janë: Petrova, Reçaku, Zborci, Gjyrvovci. Problem tjetër shumë i madh që vlerësohet nga qytetarët është derdhja e kanalizimeve që bëhen kryesisht në shtratin e lumit "Shtimjanja".

Trendet buxhetore në Komunën e Shtimes (2017)

Komuna e Shtimes në vitin 2017 ka planifikuar 6.4 milion euro buxhet.⁵ Në këtë buxhet do të barten nga viti 2016 edhe rreth 84 mijë euro tjera nga të hyrat vetanake të pashpenzuara,⁶ ndërsa në vitin 2013 janë bartur rreth 39 mijë euro më pak se këtë vit.⁷ Krahasuar me buxhetin e

⁴ MAPL, Raporti i Përformacës së Komunave 2016. Burimi: <http://bit.ly/2t297r8>, faqe 118


⁵ Shih për më shumë platformën buxhetore të Institutit GAP në <http://bit.ly/2trS1CV>

⁶ Ministria e Financave, Raporti vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016. Burimi: <http://bit.ly/2eFtgKj>, faqe 63

⁷ Ministria e Financave, Raporti vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2012. Burimi: <http://bit.ly/2wKArjf>, faqe 60


planifikuar të vitit 2013, Komuna e Shtimes ka pasur një rritje të buxhetit për rreth 1.2 milion euro.

Figura nr.1: Buxheti i Komunës së Shtimes 2017



Në bazë të grafikonit të mëposhtëm shohim se Komuna e Shtimes më së shumti shpenzon për paga dhe mëditje më një trend në rritje që nga 2013 e tutje. Ndërkaq investimet kapitale kanë pasur lëvizje të ndryshme, ku në vitin vitin 2015 ka pasur rënie dhe sërish ngritje në 2016 dhe 2017.

Figura nr.2: Trendët buxhetore në Shtime 2013 dhe 2017




Rritja e buxhetit në vitin 2017 krahasuar me kohën e zgjedhjeve të fundit në 2013 është bërë në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, investimeve kapitale dhe mallrave dhe shërbimeve.

Për paga dhe mëditje buxheti është rritur për rreth 900 mijë euro, por me pjesëmarrje në buxhet total është zvogëluar për një pikë përqindjeje nëse e krahasojmë me buxhetin e planifikuar në 2013. Kjo rritje mund të jetë si rezultat i vendimit të kryeministrit në vitin 2014⁸ për të rritur pagat për 25% në sektorin publik si dhe rritja e numrit të punësuarve për 10 persona në këtë vit. Por, përveç të punësuarve të rregullt, Komuna e Shtimes ka punësuar edhe 10 persona me kontrata të veçanta të cilët janë jashtë listës së pagave.

Ngjashëm edhe shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve janë rritur për mbi 88 mijë euro, por në pjesëmarrje të buxhetit është zvogëluar për një pikë përqindjeje krahasuar me vitin zgjedhor paraprak. Investimet kapitale në 2017 janë afër 1.6 milionë euro me një rritje prej 500 mijë eurosh nga viti 2013 dhe pjesëmarrje më të madhe në buxhet me 25%.


Figura nr.3: Përqindja e pagave dhe investimeve kapitale në buxhetin e vitit 2017



Komuna e Shtimes gjatë vitit 2016 ka pasur të hyra në vlerë prej 470 mijë euro, shifër kjo për rreth 169 mijë euro me e lartë se të hyrat e realizuara në 2013.

⁸ Zyra e Kryeministrit, Vendimet e mbledhjes së 172-të të qeverisë. Burimi: <http://bit.ly/2w6MK0M>

Figura nr.4: Të hyrat vetanake në Komunën e Shtimes 2013-2016



Burimi. Zyra Kombëtare e Auditimit

Rekomandimet

Duke u bazuar në problemet kryesore, fushat të cilat kërkojnë vëmendjen e Komunës dhe trendet buxhetore, Instituti GAP rekomandon që qeverisja e komunës e dalë nga zgjedhjet lokale të 2017 të ndërmer këto veprime:

- Komuna duhet t'i shtojë kontrollet ndaj kompanive të gurthyesve me qëllim të sigurimit se këto kompani po i respektojnë standardet mjedisore dhe standardet e tjera të operimit.
- Komuna duhet të rrisë buxhetin në kategorinë e investimeve kapitale dhe pjesën dërrmuese të parave nga kjo kategori të dedikoj në rregullimin dhe zgjerimin e rrjetit të kanalizimeve.
- Komuna duhet të shohë mundësitë që ka për krijimin e parkingjeve për automjete veçmas në zonat urbane.

Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Ky projekt mbështetet nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world